



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.12, datë 24.01.2022

**PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. **Znj. Elidjana Kasa**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Znj. Elidjana Kasa, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga data 25.01.2022 - 23.04.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim znj. Elidjana Kasa, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm znj. Elidjana Kasa do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, në masën 40%.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR  
SOKOL STOJANI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ZEQIR HOĐA**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
LUDOVIK DODAJ**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**